



PRISHTINA

 NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH. A. G.J.P "AUTOBUSKA STANICA" A. D. MPE "BUS STATION" J. S.	
Nr. <i>08/1974</i>	Data <i>19.10.2020</i>
No.	Date
PRISHTINË/A	



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË
 G.J.P "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISHTINA
 MPE "BUS STATION" J.S. PRISHTINA

FTESË PËR ANKAND PUBLIK

(Dhënia e hapësirave/lokaleve me qira dhe shitja e automjetit të përdorur)

1. Dhënia e hapësirave afariste me qira

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë njofton të gjithë të interesuarit se ofron hapësirat/lokalet për qiradhënie përmes procedurës së ankandit publik, si në vijim:

Nr.	Njësia	Sipërfaqja/ m ²	Nr. i lokalit	Çmimi fillestar/€
1.	Sportel nr. 2	/	2	200.00
2.	Lokal	8.32	17	174.72
3.	Lokal	8.32	18	174.72
4.	Hapësirë afariste - Zyre	382.94	22	800.00
5.	Depo	28.16	32	197.12
6.	Hapësirë parkingu për autobusë	539.00	33	431.20

Shënim: Të gjitha çmimet janë pa TVSH.

Kriteri i dhënies së kontratës është çmimi më i lartë i ofruar. Në rast që ekziston vetëm një ofertë lidhur me njësinë afariste të caktuar, Bordi i Drejtoreve të ndërmarrjes ka të drejtë të beje negociata me palën e interesuar lidhur me çmimin final të njësisë afariste të caktuar.

Preferencat e dëshirueshme për lëshimin hapësirave me qira gjatë procesit të ankandit:

- Për sportelin nr.2 preferohet zyre, apo veprimtari e ngjashme për kompanitë e auto transportuese
- Për lokalet nr.18 dhe nr.22 preferohet zyre, apo veprimtari të ngjashme, për kompani autotransporteve, apo ndonjë veprimtari tjetër e lejuar dhe e cila nuk bie ndesh me veprimtarinë e NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë ;
- Për lokalin me nr.32, preferohet depo, garazh për servisim apo veprimtari të ngjashme;
- Për njësinë nr.33, preferohet parkingu për autobusë dhe automjete tjera.

Të drejtë pjesëmarrje kanë personat juridik. Si dëshmi ofrojnë certifikatën e regjistrimit të biznesit. Afati i dhënies me qira është një (1) vjeçar me mundësi vazhdimi.

2. Shitja e veturës të përdorur

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë njofton të gjithë të interesuarit se ofron shitjen e automjetit të përdorur, përmes procedurës së ankandit publik, si në vijim:

Lloji veturës	KIA
Viti	2002
Ngjyra	E hirit
Kapaciteti	1,793 cm ³
Karburanti	Benzinë
Çmimi fillestar (me TVSH)	500.00 €

Për blerjen e automjetit të përdorur të drejtë pjesëmarrje kanë të gjithë personat juridik dhe fizik.

3. Kushtet dhe obligimet tjera

- Nga e drejta e pjesëmarrjes në ankand janë të përjashtuar të gjithë debitorët që kanë obligime të pa shlyera ndaj ndërmarrjes NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë.
- Te gjitha palët e interesuara mund t'i shikojnë hapësirat/lokalet dhe automjetin çdo ditë pune nga ora 08:00 deri me 16:00.
- Afati për dorëzimin e ofertave është deri me 30.10.2020, ora 14:00, hapja e ofertave bëhet në orën 14:30.
- Ofertat dorëzohen në zarfe të mbyllura dhe dorëzohen në zyrën e arkivit të ndërmarrjes.
- Të drejtë pjesëmarrje në hapjen e ofertave kanë të gjithë ofertuesit.
- Palët fituese në afatin prej 5 ditësh pas mbylljes së procedurës së ankandit duhet të nënshkruajnë kontratat mbi qiranë, dhe të bëjnë pagesën e faturës së pare, respektivisht ta bëjnë pagesën e veturës së blerë dhe të marrin përsipër shpenzimet e kontratës për shitblerjen e veturës.

Informatat me të hollësishme mund të merren përmes emali-t : contact@sap-rks.com.
apo në numër të telefonit 038 551 333.